



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
GJIROKASTËR

Gjirokastrë, më 01/04/2025



“ANALIZA VJETORE - 2024”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë

✚ Znj. Entela Selmanaj, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me datën 01.04.2025 prezantoi përpara trupës gjyqësore të kësaj Gjykate, si dhe para të ftuarve, "Analizën vjetore të punës për vitin 2024".

✓ Në prezantimin e punës për vitin 2024, përveç trupës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë morën pjesë Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor Prof. Asoc. Dr. Z. Ilir Rusi, Zv/Drejtuuesi i Prokurorisë Z. Gazmend Frëngu, Prokuroria e Medias Znj. Denisa Plaku, Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Z. Altin Merizaj, Kryetari i Dhomës së Avokatisë Gjirokastrë Z. Arjan Sotiri, Drejtori i Drejtorisë Vendore të Shërbimit të Provës Z. Afrim Mullaj dhe Znj. Esmeralda Dilo përfaqësuesja e Filialit të Postës Shqiptare.

✓ Në analizën e punës për vitin 2024 u trajtuan treguesit që lidhen me performancën në menaxhim dhe në vendimmarrje. Treguesit që lidhen me ofrimin e shërbimeve administrative duke u siguruar palëve të interesuara akses të vazhdueshëm, informim të saktë dhe të shpejtë, me qëllim rritjen e besimit të publikut, kanë qenë në fokus të veprimtarisë së këtij institucioni.

✓ Përveç analizës së punës, evidentimit të përmirësimeve, apo arritjeve, u tregua vëmendje e veçantë ndaj sfidave dhe problematikave të hasura gjatë veprimtarisë administrativo-gjyqësore,

sidomos për shkak të ngarkesës së madhe të punës me të cilën po përballet aktualisht Gjykata, me qëllim shmangien e tyre në të ardhmen.

✓ Zv/Kryetarja vlerësoi kontributin e çdo punonjësi, kontributin e institucioneve pjesëmarrëse, si dhe inkurajoi trupën gjyqësore dhe administratën e kësaj Gjykate për arritje dhe rezultate më të mira.

📌 Në datën 01.04.2025 u zhvillua gjithashtu edhe procesi për “Zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Gjykatës”. Në procesin e zgjedhjeve mori pjesë trupa gjyqësore (4 gjyqtarë) dhe u paraqitën dy kandidatura Znj. Entela Selmanaj dhe Znj. Orinda Lloshi.

Në përfundim të procesit të zgjedhjeve, si Zv/Kryetare e Gjykatës u zgjodh Znj. Entela Selmanaj.

📌 I urojmë Znj. Entela Selmanaj suksese në ushtrimin e detyrës si Zv/Kryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

📌 I urojmë gjithashtu suksese edhe Znj. Orinda Lloshi si anëtare e Këshillit të Gjykatës, pas riformatimit të Këshillit të Gjykatës.

